VIDEO/ Të shtënat me armë drejt një kompleksi në Yrshek, zbulohet banesa e grupit kriminal, sekuestrohet arsenal armësh, një në pranga

19 Qershor, 2020 15:12 |

Tiranë - Finalizohet operacioni policor i koduar "Yrsheku". Sekuestrohen arsenal armësh dhe municione luftarake.

Madhësia e tekstit:

TIRANË

Policia e Tiranës finalizon operacionin e koduar "Yrsheku" duke arrestuar një prej autorëve të sulmit me armë drejt një kompleksi në Yrshek, ngjarje e ndodhur më 15 qershor.



Sipas të dhënave zyrtare, menjëherë pas ngjarjes së ndodhur në datën 15.06.2020, në rrugën dytësore Tiranë-Vorë, në fshatin Yrshek, ku u qëllua me armë në drejtim të një kompleksi, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6 organizuan punën për zbardhjen e ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Si rezultat i veprimeve intensive u siguruan informacione në rrugë operative se armët e përdorura dhe motomjeti me të cilin ishin larguar autorët ndodheshin në banesën e shtetasit Gëzim Haroku.

Po në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative dyshohet se bashkautor në këtë ngjarje është edhe shtetasi Erigers Mihasi.

Gjithashtu, po në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative dyshohej se banesa e shtetasit Gëzim Haroku mund të përdorej si bazë për të fshehur armët dhe municionet luftarake të grupit kriminal.

Bazuar në këto informacione, shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, të mbështetura nga Forca e Posaçme "Shqiponja", organizuan dhe finalizuan operacioni "Yrsheku", në kuadër të të cilit u vu në pranga shtetasi Gëzim Haroku dhe u shpall në kërkim shtetasi Erigers Mihasi.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit Gëzim Haroku, shërbimet e Policisë zbuluan një arsenal armesh dhe municionesh që përdoreshin nga një grup i strukturuar kriminal, pjesë e të cilit ishte edhe shtetasi Gëzim Haroku.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar 15 armë zjarri (1 mitraloz i lehtë, 7 kallashnikovë, 3 pistoleta, 2 armë automatike MP7, 1 pushkë me dylbi dhe 1 armë gjahu), 10 granata dore, 10 detonatorë, 10 kallëpe me tritol dhe fitil zjarrpërcjellës, një sasi fishekësh, një automjet dhe dy motorë sportivë.

Në drejtimin e Prokurorisë vijon puna për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje, identifikimin e pjesëtarëve të tjerë të këtij grupi kriminal dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale të këtij grupi.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arme policia te shtena me arme yrshek

BW Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

"Mirëserdhe Emi", mamaja e Jonida Vokshit i bën pritjen e ëmbël në shtëpi mbesës së porsalindur
21 Qershor, 2020

FOTO/ Vrau 3 persona. Kush është autori i sulmit në Angli, agresori është terrorist
21 Qershor, 2020

VIDEO/ Serie A post Covid-19, Gjimshiti ndëron Atalantën, e nis me gol
21 Qershor, 2020

Blendi Klosi: Janë hedhur 500 deri 600 milionë lekë investime në hoteleri, të gjithë operatorët në gatishmëri për të krijuar destinacione turistike
21 Qershor, 2020

Detaje nga plagosja në Lezhë/ Në përplasje të përfshira dy grupe, zbulohet identiteti i autorit
21 Qershor, 2020

Pjanic, De Sciglio dhe një ndërmjet Neymar ose Martinez, zbardhet plani i Barcelonës
21 Qershor, 2020

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

TË NGJASHME

E qëlluan me armë, kush është 48-vjeçari që u dogj 3 herë lokali, problemet me dy ish-gratë dhe dënimi i vëllezërve për drogë
21 Qershor, 2020

Breshëri plumbash ndaj makinës në Elbasan, babë e bir i shpëtojnë mekullisht atentatit. Ja çfarë deklaruan në polici
21 Qershor, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Detaje nga plagosja në Lezhë/ Në përplasje të përfshira dy grupe, zbulohet identiteti i autorit
21 Qershor, 2020

Të shtëna me armë zjarri në Lezhë, 1 plagosur (Emri)
21 Qershor, 2020

Bie zjarr në katin e fundit të një banese te "Don Bosko", nuk ka të lënduar
21 Qershor, 2020

Punëtorët bien nga larësia në Tiranë, dërgohen urgjentisht në spital
21 Qershor, 2020

Atentati ndaj Ardian Çapjas, News24 zbardh ekspertizën e specialistëve të RENEA-s: U qëllua nga 346 m largësi
21 Qershor, 2020

Sherr mes doganierëve në Sarandë, 34-vjeçari godet fizikisht kolegun, arresohet nga policia
21 Qershor, 2020

KATEGORIA VIDEO

Atentati ndaj Ardian Çapjas, News24 zbardh ekspertizën e specialistëve të RENEA-s: U qëllua nga 346 m largësi
21 Qershor, 2020

Ngacmoi seksualisht të miturën, Gjykata lë në burg 48-vjeçarin. Aanjë avokat nuk pranon ta mbrojë, i caktohet kryesisht. Zbulohen detaje për ngjarjen
Enxhëla Petova | 21 Qershor, 2020

Rudina Xhunga: Gjirokastra kërkë verë nuk njihet, shko ta shijosh vetë!
21 Qershor, 2020

Raporti i Venecias për 'Anti-shpifjen', Vokshi: Rama bën lojë të rrezikshme, po kërcënon integrimin e Shqipërisë
21 Qershor, 2020

Lënshaj në Konispol: Zyra e aplikimit për mjete biometrike identifikimi, lehtësi për mijëra qytetarë
21 Qershor, 2020

(Video) Fundjava në plazhin e Golemit dhe Durrësit, pushuesit: Të kënaqur me kushtet që ofrohen. Gjysmë qetësinë dhe sigurinë e duhur
Ida Ismalaj | 21 Qershor, 2020

© 2020 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.